

Ne përputhje me Nenin 28 paragrafi 3 i Ligjit 9723/2007 Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit ky dokument përben:

**AKTI I THEMELIMIT**

**DHE**

**STATUTI**

**I**

**SHOQERISE**

**"Swiss Balancing Pool" SHPK**

**TIRANE / SHQIPERI**

AKTI I THEMELIMIT

DHE

STATUTI

i

Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar

"Swiss Balancing Pool" Shpk

KAPITULLI I

Emri, Forma, Selia, Kohezigjatja

Neni 1. Data e Themelimit dhe Emri

- 1.1 Me efekt nga data 21.09.2023 themelohet shoqëria "**Swiss Balancing Pool**" (ne vijim "**Shoqëria**"), e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "Shpk", cili perfaqeson formen ligjore te saj, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- 1.2 Ortaket e Shoqërise ("**Ortaket**") gezojne përgjegjësi te kufizuar deri ne limitin e kontributit perkates ne kapitalin e shoqërise te perfaqesuar ne kuota.
- 1.3 Ne te gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet te leshuara nga Shoqëria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri i saj do te ndiqet ose do te shoqërohet nga:
- (i) fjalet "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "shpk";
  - (ii) numri i Identifikimit Personal Tatimor (NIPT) te saj;
  - (iii) adresa e regjistruar, dhe
  - (iv) dhe pasqyrimin e faktit qe shoqëria eshte ne procedura likuidimi, ne qoftese ky rast paraqitet.
  - (v) Kapitalin e regjistruar te Shoqërise dhe kapitalin e paguar te Shoqërise.

Neni 2. Forma Ligjore

- 2.1. Shoqëria eshte nje entitet ligjor shqiptar, dhe ka formen ligjore te nje shoqërie me përgjegjësi te kufizuar ("shoqëri me përgjegjësi të kufizuar"), ne perputhje me ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" ("**Ligji i Shoqërive**").

Neni 3. Selia

- 3.1. Selia e Shoqërise ndodhet ne adresen: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Rogner Hotel, Kati I, Kodi Postar 1000, Tirane, Shqiperi. Shoqëria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjeter te Shqiperise. Shoqëria mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Neni 4. Kohezigjatja

- 4.1. Kohezigjatja e shoqërise eshte e pacaktuar.

KAPITULLI II

Neni 5. Objekti i Shoqerise

- 5.1. Objekti aktivitetit te Shoqerise do te jete te kryej cdo aktivitet tregtar te lejuar nga legjislacioni Shqiptare, duke perfshire, por pa u kufizuar ne aktivitetet e poshtme:
- Ofrimi i sherbimeve IT dhe balancuese per panelet diellore, hidrocentrale dhe klientët me pakice në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, Bosnje dhe Hercegovinë etj.;
  - Funksionimi si nje qendra dispeçer per sherbimet IT (menaxhimi i planifikimit, ofrimi i sherbimeve mbeshetese, emerimi etj.);
  - Menaxhimi i tregut me pakice;
  - Menaxhimi i PPA-së;
  - Per sherbimet e mesiperme, Shoqeria do te dizenoje dhe krijojë softuer per te krijuar nje grup balancues dhe per te menaxhuar prodhimin ne kohe reale;
  - Cdo veprimtari tjetër te lejuar nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 6. Ndryshime

- 6.1. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe sic parashikohet ne kete Statut.

**KAPITULLI III**

**Kapitali Themeltar: Quotat e Kapitalit Themeltar**

Neni 7. Kapitali Themeltar

- 7.1. Kapitali i Shoqerise eshte ne total **100** (nje qind) **Leke**, plotesisht te nenshkruara dhe te pashlyera.
- 7.2. Kapitali i Shoqerise do te shlyhet nga Ortaket, ne proporcion me pjeset e tyre takuese, brenda nje periudhe prej 1 viti nga data e regjistrimit te Shoqerise ne QKB.

Neni 8. Ortaket e Shoqerise dhe Kuotat

- 8.1 Ortaket e Shoqerise dhe kuotat e zoteruar prej tyre ne Shoqeri jane si me poshte:
- (i) **Besiana Antoni** lindur me 15.10.1988 Tirane, Shqiperi, banuese ne Rruga Deshmoret e 4 Shkurtit, 24/1, nr 22, Tirane, Shqiperi, mbajtese e pasaportes me nr. BI0486601 qe zoteron nje kuote qe perfaqeson **90 %** te kapitalit te Shoqerise, ne vleren **90 Leke**; dhe
- (ii) **Esli Zala**, lindur me 27.03.1988, ne Tirane, Shqiperi, banuese ne Rruga Zhan Dark Building 26, H. 6, Ap. 45, Tirane, Shqiperi, mbajtese e pasaportes me nr. BD955817, qe zoteron nje kuote qe perfaqeson **10 %** te kapitalit te Shoqerise, ne vleren **10 Leke**.

Neni 9. Zvogelimi ose Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

- 9.1 Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Kapitullin IV te ketij Statuti, dhe kerkesave te detyrueshme te Ligjit te Shoqerive.
- 9.2 Zmadhimi i kapitalit mund te realizohet me ane te kontributeve ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave (nese ka) dhe fitimit.
- 9.3 Rritja e kapitalit do te behet me kuota te reja apo me rritjen e vleres se kuotave ekzistuese. Pjeset e reja te kapitalit themeltar do te nenshkruhen dhe vlera e tyre nominale do te paguhet plotesisht.
- 9.4 Zmadhimi i kapitalit nuk do te dobesoje pjeset e interesit te Ortakeve ne Kapitalin e Shoqerise, pervecse kur vendoset ndryshe nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, vendim i cili do te merret me nje shumice prej 95% te votave.

9.5 Shoqeria nuk mund te bleje asnje kuote te saj, Megjithate, me qellim zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, nepermjet vendimit per zvogelimin e kapitalit, Ortaket mund te autorizojne Administratorin/Administratoret te bejne blerjen e kuotave perkatese apo pjese te tyre dhe t'i anulojne ato.

#### Neni 10. Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve

10.1 Ortaket jane vetem ata te cilet zoterojne kuotat e Shoqerise.

10.2 Cdo Ortak do te kete te dehta vote ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve ("**Asambleja e Pergjithshme**") ne perpjestim me vleren nominale te kuotes qe zoteron. Cdo Ortak ka te drejten per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur ne organet drejtuese, te drejten per te marre pjese ne shperndarjen e fitimeve te Shoqerise, nese Asambleja e Pergjithshme vendos te shperndaje fitimet, sikunder te drejtat e parashtikuara nga ky Statut, per cdo marreveshje te detyrueshme ndermjet Ortakeve dhe dispozitave ligjore te Ligjit te Shoqerive.

10.3 Ortakeve do t'u jepen, me kerkese me shkrim, informacione dhe te dhena ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise ne cdo kohe, duke perfshire te drejten qe te kontrollojne dokumentat dhe raportet e Shoqerise.

10.4 Te drejtat dhe detyrimet qe rezultojne nga zoterimi i Kuotave, transferohen tek cdo zoterues i ri per keto Kuota.

10.5 Detyrimet e Shoqerise jane te garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortaket mundet vetem te mbajne pergjegjesi brenda limitit te vleres se kuotave qe ata zoterojne. Ortaket nuk mbajne pergjegjesi qe tejkalojne investimin e tyre perkatesisht ne kapitalin e Shoqerise (pervec garancive dhe huave qe ata realizojne).

10.6 Shoqeria nuk mban pergjegjesi per borxhe ose detyrime te tjera te Ortakeve te saj.

#### Neni 11. Transferimi i pjeseve te Kapitalit

11.1 Pjeset e kapitalit transferohen lirisht midis Ortakeve.

11.2 Ne rast se nje Ortak do te shese, transferoje, ose perdore ne menyra te ndryshme pjese apo te gjitha kuoten e tij Ortaku tjetër do te kete te drejten e parablerjes, kundrejt blesesve te tjere. Nese Ortaku me te drejte parablerjeje do te kete bere nje oferte dhe kjo oferte eshte refuzuar nga Ortaku qe shet, atehere Ortaku tjetër do te rishikojë oferten e bere dhe do t'i beje Ortakut qe shet nje oferte te dyte.

Nese edhe kjo oferte e dyte eshte refuzuar nga Ortaku qe shet, atehere ky i fundit (Ortaku qe shet) nuk do te kete te drejte te shesi kuoten tek nje bleses tjetër me cmim me te ulet se cmimi i ofruar nga Ortaku i preferuar ne oferten e dyte.

11.3 Cdo transferim i kuotave do te behet ne perputhje me dispozitat e Ligjit te Shoqerive dhe duhet te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Biznesit.

### KREU IV

#### Asambleja e Pergjithshme

#### Neni 12. Kompetencat

12.1 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi drejtues i Shoqerise i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.

#### Neni 13. Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme

13.1 Asambleja e Pergjithshme duhet te mbledhet te pakten 1 here ne vit.

13.2 Asambleja e Pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitetet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

13.3 Asambleja e Pergjithshme thirret kur Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjetër aktive.

asete te cilat kane nje vlere me te larte se 5% e te gjithe asetete te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara. Asambleja e Pergjithshme do te vendose mbi bazen e raportit te ekspertit kontabel te autorizuar, qe do t'i paraqitet Asamblese, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

13.4 Asambleja e pergjithshme thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj propozon te bleje nga nje Ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% e asetete te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

13.5 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.4, Asamblese se Pergjithshme i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

13.6 Ortaket do te organizojne takime me Administratoret te pakten nje here ne vit me qellim vleres imin e veprimeve te kryera nga Administratoret, diskutimin e ceshtjeve qe kane te bejne administrimin e Shoqerise dhe marrjen e vendimeve mbi ceshtjet qe jane objekt i aprovimit nga ana e tyre, perfsjhire ceshtje per te cilat Administratoret nuk bien dakord.

13.7 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.6 Asambleja e Pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

#### Neni 14. Menyra e Thirrjes se Mbledhjeve

14.1 Asambleja e Pergjithshme thirret te vendose per ceshtjet e shtruara perpara saj nepermjet thirrjes se mbledhjeve ose nepermjet konsultave me shkrim.

14.2 Asambleja e pergjithshme mund te thirret nga nje prej Administratoreve ose nga cdonjeri prej Ortakeve.

14.3 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne seline e Shoqerise, ne Shqiperi apo ne cdo qytet apo province te botes sic bihet dakord midis Ortakeve. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe rendi i dites perkates i mbledhjeve u njoftohet Ortakeve me poste te regjistruar te pakten 7 dite para mbledhjes. Ne rast se Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se te gjithe Ortaket bien dakord.

14.4 Secili prej Ortakeve gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjetër ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.

14.5 Ortaket pranojne dhe bien dakord me te drejten per te marre vendime ne lidhje me Shoqerine ne forme te shkruar. Vendimi i propozuar se bashku me dokumentacionin mbeshketes do t'u dergohet Ortakeve me poste, korrier, telecopy ose menyra te tjera elektronike te sigurta. Ortaku(et) do te marrin vendim per rezoluten perkatese brenda nje periudhe prej 15 ditesh nga dita qe ju eshte dorezuar rezoluta. Ortaku(et) miratojne rezoluten duke i kthyer Administratorit(eve) te Shoqerise nje kopje te firmosur te rezolutes me shkrim. Ortaket te cilet nuk jane dakord me rezoluten shprehin me shkrim kundershite e tyre ne lidhje me rezoluten dhe i'a kthejne ate Administratorit(eve) te Shoqerise. Rezoluta me shkrim konsiderohet e miratuar nese aprovohet me tre te katertat e votave te ortakeve pjesemarres.

14.6 Secili prej Ortakeve ka te drejten te votoje ne perputhje me kuoten e zoteruar prej tij ne kapital.

14.7 Vendimet e meposhtme do te miratohen me miratimin e Ortakeve qe zoterojne te pakten 95% te kapitalit te Shoqerise:

(i) Pagesa e cdo dividenti ne kesh apo natyre Ortakeve te Shoqerise;

(ii) Nenshkrimi i marreveshjeve financiare ne lidhje me Shoqerine apo nxjerrja e instrumentave te borxhit nga Shoqeria;

(iii) Blerja e cfaredolloj kuote apo interesi tjerter ne cdo biznes dhe sipermarrje;

(iv) Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise sic eshte percaktuar ne Nenin 7 te kesaj Marreveshje;

(v) Ndryshime dhe amendime te ketij Akti Themelimi; dhe

(vi) Likuidimi apo shperndarja e Shoqerise.

14.8 Atehere kur ligji e kerkon kete, rezolutat e Ortakeve duhet te noterizohen nga nje noter publik Shqiptar. Ne rast se keto rezoluta miratohen jashte Republikes se Shqiperise, ato duhet t'i nenshtrohen kerkesave te ligjit Shqiptar per njohjen e dokumenteve te huaja ne Republiken e Shqiperise (dmth duhet t'i nenshtrohen



procedures se superlegalizimit ose apostillimit, ne varesi te vendit ku leshohen).

14.9 Ortaket do te njoftohen per Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve dhe permbajtjen e axhendes se takimit.

14.10 Administratoret duhet te mbajne procesverbalet e cdo mbledhjeje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me kerkesat e nenit 90 te Ligjit te Shoqerive.

#### Neni 15 Perjashtimi nga e drejta e votes

15.1 Nje ortak perjashtohet nga e drejta e votes ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme eshte duke vendosur mbi:

- (i) Vleresimin e veprimtarise se ketij Ortaku.
- (ii) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
- (iii) Ngritjen e nje padie kunder tij, nga Shoqeria.
- (iv) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

15.2 Kur ky Ortak eshte i perfaqesuar nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi sikunder Ortaku te cilin perfaqeson.

### KREU V

#### Administratoret

#### Neni 16. Bordi i Administratoreve dhe kompetencat

16.1 Shoqeria drejtohet nga Administratori(et). Administratoret mund te jene te cdo kombesie dhe nuk eshte e nevojshme te jene rezidente ne Shqiperi.

16.2 Administratori i Shoqerise eshte:

- Zoti Artur Mustafaraj, lindur me 20.02.1968, ne Skrapar, Shqiperi, me banim ne Tirane, Shqiperi, me leternjoftim me nr. BR2504177

16.3 Kohezgjatja e funksionit te Administratoreve eshte per nje periudhe prej 3 vjetesh, duke filluar qe nga momenti kur kjo detyre merr fuqi ligjore (dmth regjistrimi prane Qendres Kombetare te Biznesit), me te drejte ripertesitje te ketij mandati.

16.4 Menjehere pas pranimi te emerimit te tyre, Administratori(et) njohin se marredhenia e tyre me Shoqerine ndertohet mbi baza mirebesimi; lidhur me kete vendimi per heqjen e tyre nepermjet nje vendimi te Asamblese se Ortakeve gjykohet si arsye e ligjshme per shkarkimin e tyre, ne perputhje me ligjet perkatese.

16.5 Ortaket kane te drejten te shkarkojne Administratoret me shumice te thjeshte votash.

16.6 Secili prej Administratoreve duhet te informoje Ortaket per cdo veprim dhe te marre paraprakisht miratimin e tyre per cdo veprim qe ndemmerret ne cilesine e administratorit.

16.7 Per aq sa eshte e lejueshme dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ose me cdo legjislacion ku aktet e Administratorit(eve) kane fuqi vepruese, Administratori(et) kane te drejten te marrin vendime ne lidhje me detyrat e tyre pa qene fizikisht present ne Shqiperi ose ne ambientet e Shoqerise. Shoqeria u rimburson Administratorit(eve) shpenzimet e arsyeshme gjate udhetimeve lidhur me prezencen e detyrueshme te Admnsitatorit(eve) ne vende qe nuk jane brenda qytetit te residences se Administratorit(eve), me kusht qe shpenzimet te jene te justifikuara dhe te kene qene te miratuara paraprakisht.

#### Neni 17 Kompetencat dhe detyrimet

17.1. Kompetencat e Administratoreve (secili individualisht) ne kuader te perfaqesimit te Shoqerise perfshijne:

- (i) ~~Thirrjen e Asamblese se Pergjithshme, ne rastet e specifikuara ne nenin 13.~~
- (ii) Menaxhimin e aktivitetit tregtar te shoqerise nepermjet implementimit te politikave dhe planeve te percaktuara nga Asambleja e Pergjithshme.
- (iii) Perfaqesimin e Shoqerise.
- (iv) Kujdesin per mbajtjen ne menyre te pershtatshme te dokumentave dhe librave kontabel te Shoqerise.

- (v) Pergatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit te konsoliduar dhe raportit te ecurise se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve qe i paraqiten per miratim Asamblese se Pergjithshme.
  - (vi) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit, kur eshte e nevojshme.
  - (vii) Raportimin perpara Asamblese se Pergjithshme, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise.
  - (viii) Kryerjen e detyrave te tjera te caktuara ne ligj dhe nga Ortaket.
- 17.2. Administratori(et) mbikqyrin dhe sigurojne qe zyrtaret, agjentet, te punesuarit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerise te veprojne me kujdesin e duhur dhe te mbrojne sa me mire interesat e Shoqerise. Administratori(et) duhet te raportojne tek Ortaket ne lidhje me personat te cilet emerohen nga Ortaket.

#### Neni 18 Detyrimi i besnikerise dhe pergjegjesia

- 18.1 Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 16, 17 e 18 te Ligjit te Shoqerive, Administratoret detyrohen:
- (i) te kryejne detyrat e tyre e percaktuara ne ligj ose ne kete Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se Shoqerise ne mjedis;
  - (ii) te ushtrojne kompetencat qe u njihen me ligj ose nga ky statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
  - (iii) te vleresojne me pergjegjesi ceshjtjet per te cilat merret vendim;
  - (iv) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqerise;
  - (v) te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem
- 18.2 Administratoret gjate kryerjes se detyrave te tyre pergjigjen kundrejt shoqerise per cdo veprim apo mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e Shoqerise, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprim apo mosveprim eshte kryer ne mirebesim.
- 18.3 Ne rast te shkeljes se detyres dhe standarteve profesionale, sipas pikave 18.1 dhe 18.2 te ketij neni, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje Shoqerise cdo fitim personal qe ka realizuar gjate kryerjes se ketyre veprimeve te parregullta. Ai ka barren e proves per te vertetuar se kryen detyrat e tij ne rregull dhe sipas standarteve. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje Administrator ata pergjigjen ndaj Shoqerise ne menyre solidare.
- 18.4 Ne vecanti, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet, neqoftese ne kundershim me Ligjin e Shoqerive kryen veprimet e meposhtme:
- (i) i kthen Ortakeve kontributet;
  - (ii) i paguan Ortakeve interesa apo dividende;
  - (iii) i shperndan asetet Shoqerise;
  - (iv) lejon qe Shoqeria te vazhdoje aktivitein e saj, kur duhet ta kishte parashikuar qe kjo e fundit nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet e saj;
  - (v) jep hua.

#### KREU VI

#### Administrimi Financiar i Shoqerise

#### Neni 19. Eksperti Kontabel i Autorizuar

- 19.1 Ortaket mund te caktojne ekspertin kontabel te autorizuar per t'i sherbyer Shoqerise.

19.2 Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

## KREU VII

### Aktiviteti i Shoqerise

Neni 20. Viti ekonomiko-financiar

20.1 Viti ekonomiko-financiar fillon ne ditën e pare te muajit Janar dhe perfundon ne ditën e 31-te te muajit Dhjetor te secilit vit. Viti i pare financiar nis ne datën e themelimit te Shoqerise.

Neni 21. Mbajtja e Llogarive

21.1 Shoqeria do te mbaje llogarite ne leke dhe ne monedhe te huaj.

Neni 22. Llogaritja dhe Shperndarja e Fitimit

22.1. Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te bilancit te aprovuar nga Asambleja e Pergjithshme. Shperndarja e fitimit do te caktohet nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me Statutin, marreveshjen e Ortakëve dhe me ligjet e zbatueshme.

22.2. Nga fitimet vjetore, do te caktohet nje fond rezerve ne perputhje me kushtet e legjislacionit shqiptar per fondin rezerve te detyrueshem.

22.3. Ne baze te Ligjit per Shoqerite, Shoqeria mund te shpermdaje fitimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj shpermdarje:

asetet e Shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e kesaj te fundit:

(i) Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve te ardhshem.

22.4. Administratoret leshojne nje certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e pikes 22.3 me sipër. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush keto kritere, administratoret nuk mund ta leshojne kete certifikate.

22.5. Administratoret pergjigjen ndaj Shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

## KREU VIII

### Modifikimi i Formes Ligjore: Prishja

Neni 23. Modifikimi i Formes Ligjore

23.1 Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme ne perputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.

23.2. Shoqeria e re do te permbushë te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit ne Shqiperi.

Neni 24. Prishja e Shoqerise

24.1 Shoqeria mund te priset ne rrethanat e meposhtme:

(i) si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes per te cilin ishte themeluar;

(ii) me vendim te Asamblese se Pergjithshme;

(iii) hapje e nje procedure falimentimi;

(iv) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne



perputhje me piken 3 te nenit 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit":

(v) me vendim gjykate;

(vi) per arsye te tjera te parashikuara nga Ortaket ne cdo kohe.

24.2 Administratori(et) regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Ne rast se prishja e Shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ia njoftimin vendimin kesaj te fundit per regjistrim.

## KREU IX

### Te ndryshme

Neni 25. Largimi i Ortakut

25.1 Largimi dhe perjashtimi i nje Ortaku, si dhe pasojat qe kjo sjell, do te rregullohen nga nenet 101, 102, 103 te Ligjit te Shoqerive.

Neni 26 Te tjera

26.1. Cdo ceshtje tjeter, e cila nuk eshte permendur ne kete statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite.

**Nenshkrimi**

**I Themeluesve/Ortakeve**





